

PROF. PETRAQ PILIKA

(1924 –)

MINGA A.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Matematikës

Njerëzit e shquar, që me personalitetin e tyre të spikatur dhe me veprimtarinë e frytshme në fushën së cilës i janë përkushtuar lënë gjurmë të pashlyeshme dhe hapin perspektiva zhvillimi, janë pasuri e vërtetë kombëtare. Ata i çimentojnë traditat e një vendi, sepse shndërrohen në pika të sigurta referimi të periudhave të caktuara. Në këtë kontekst të përgjithshëm, autoritetet shkencore, që nxjerr një komb prej gjirit të vet kanë edhe një rol disi të veçantë: për hir të funksionit shoqëror të shkencës ata kryejnë misionin e civilizimit të traditave, ndërsa për hir të universalitetit të saj krijojnë pikat e komunikimit me botën dhe të rrezatimit të vlerave të konstitucionit shpirtëror të popullit që i përkasin.

Kësaj plejade njerëzish që e nderojnë Shqipërinë i përket edhe Profesor Petraq Pilika, pionieri dhe drejtuesi i zhvillimit të shkencave matematike për gati katër dekada, ai që dha ndihmesën më të çmuar për të krijuar, nxitur e frymëzuar një gjeneratë të talentuar matematikanësh shqiptarë. Ndonëse në moshë të shtyrë e kemi përsëri në gjirin tonë, të freskët në mendime si në rininë e vet, të mprehtë në gjykimet e të saktë në vlerësimet, me po të njëjtin merak për matematikën tonë e njerëzit e saj, me po atë karakter të palëkundshëm e ndershmëri të pacenueshme.



Prof. Pepi është dhe do të mbetet ‘ustai’ i matematikës shqiptare. Nuk ka rëndësi kush e përdori i pari këtë epitet; ai gjeti miratim të menjëhershëm dhe u bë sinonimi që e përcolli në vite profesorin, sepse pasqyrore besnikërisht dy gjëra thelbësore: mjeshtërinë e lartë në profesionin e nderuar të matematikanit dhe përkujdesjen proverbiale për të mos e prishur kurrë ‘dorën

prej ustai’ në përzgjedhjen dhe formimin e brezave të specialistëve të ardhshëm.

Kam patur nderin dhe privilegjin të isha student i Prof. Pepit që nga viti 1952 dhe ishte fat që mbeta nxënës i përjetshëm i tij edhe pas 1956-ës, ndonëse koleg me të. Në këta 50 e ca vjet i kam përjetuar nga afër qëndrimet e tij në një mori situatash e ngjarjesh; e kam parë reagimin e tij në dhjetëra raste nga ato në të cilat zbulohet karakteri i njeriut; jam mësuar me logjikën e arsytimeve të tij; kam qenë dëshmitar i shpërthimeve të pasionuara kundër ‘zgjdhjeve’ që çonin në rrugë pa krye; kam ndjekur me interes të posaçëm monologjet e papërsëritshme në biseda të shumta intime.

Mbresat e cilitdo njeriu pësojnë një përthyerje individuale në shpirtin e tij, gërshetohen me emocionet dhe ndjenjat, prandaj është e kuptueshme prania e një komponenteje subjektive në to. Pastrimi i kësaj komponenteje bëhet nëpërmjet krahasimit të tyre me mbresat e të tjerëve. Ndoshta rrallë ndodh, por më duket se shmangiet në mbresat e gjithsecilit që e ka njohur dhe ka punuar me Prof. Pepin, janë të papërfillshme. Në këtë kuptim, jeta dhe veprimtaria e tij mbartin mesazhe të fuqishme njerëzore, lehtësisht të lexueshme të transkriptuara në një kod autentik moral, të padeformueshëm nga optika dhe gjykimet e pashmangshme të kohës.

* * *

Kush e ka njohur nga afër e ka punuar me Prof. Pilikën nuk mund të mos e ketë vënë re këmbënguljen e zellin e tij për studim, të cilit i përkushtohet me shpirt deri në harrim të vetvetes. Brezi im që filloi studimet më 1952, nuk do të harrojë atë pamje të përnatshme që shquhej nëpërmjet dritares së një dhome të thjeshtë të njëre prej godinave të konviktit në rrugën e Kavajës. Shokët e kursit tonë jetonin përbri saj në një godinë më të lartë nga dukej mirë dhoma e profesorit. Drita aty nuk shuhej kurrë para orës 1–2 të natës dhe ne na ka ngelur e ngulitur silueta e njohur e përkulur në tavolinën e punës, me një varg librash të shpërndara në syprinën e saj. E kjo skenë përsëritej natë pas nate, me javë, me muaj, për aq kohë sa jetoi aty. Ka një motiv psikologjik: kur studimi arrin të kthehet në burim kënaqësie intelektuale, lodhja e natyrshme fashitet e bëhet gati-gati fizikisht e pandjeshme.

Sigurisht është një karakteristikë individuale predispozita dhe aftësia, do të thosha e rrallë, e përjetimit të kësaj ndjesie sublime, por, më duket se në rastin e Prof. Pepit kanë ndikuar për mirë edhe disa rrethana të veçanta. Pilika e kishte kryer shkollimin e mesëm në Liceun e Korçës, që renditej atëherë ndër shkollat më të mira të vendit, ku, nëpërmjet standardeve të larta e të rrepta të kërkesave, kultivohej disiplina shkencore e studimit, përsiatja vetjake ndaj

rezultateve të punës intelektuale dhe njëlloj alergjie ndaj skemave shabllone. Këto në një intelekt të mprehtë lënë gjurmë të qendrueshme. Pepi u rendit në radhët e të rinjve idealistë dhe i bëri vend vetes në Lëvizjen Nacional-Çlirimtare, jo si një pjesëtar dosido i saj, por si një njeri veprimtaria e të cilit çmohej, sepse tek ai spikatnin zhdërvjelltësia e të menduarit, shkathtësia e reagimit, forca e karakterit.

Lufta ishte një shkollë për brezin e ri, që u angazhua me mish e me shpirt në të, prandaj kur Pepi filloi studimet e larta kishte pjekuri më të madhe gjykimi, përvojë më të pasur jetësore, por sidomos aftësi vlerësimi më të saktë të shanseve se të bashkëmoshatarëve të tij. Mehmat i famshëm, Fakulteti i Mekanikës dhe i Matematikës i Universitetit të Moskës, ofronte atëherë një shans të rrallë, mbase të papërsëritshëm. Ishte fat jo i zakonit të dëgjoje leksionet e korifejve që i takonin elitës së mendimit matematik botëror si Kollmogorovi, Kuroshi, Menjshovi, Gelfandi etj. Por, mbi të gjitha, ishte diçka vërtet unikale ajo atmosferë komunikimi të ngrohtë midis profesorit e studentëve, e krijuar në ato vite të pasluftës në këtë fakultet. Në seminarët me mundësi të shumta zgjedhjeje prekej pulsimit real i kërkimit të mirëfilltë, përjetohej fuqishëm aventura intelektuale e krijimit të së resë, shprehej me pastërti çdo sugjerim a kritikë shkencore. Profesorët ndanin bujarisht me studentët e interesuar idetë që dukeshin me perspektivë për zbulime, nuk e kursenin kohën e tyre të çmuar dhe bisedonin me të rinjtë që sa hidhnin hapat e parë në rrugën e mundimshme, por edhe të bukur të shkencës. *-Këto mundësi – kujton profesori – duheshin shfrytëzuar. Puna nuk më lodhte se ndjeja kënaqësi të vërtetë prej studimit.* Me vullnetin e kalitur që kishte ai i shfrytëzoi shanset si rrallëkush e me përfitim dhe formoi një kulturë solide matematike, të thellë e me spektër të gjerë.

Pilika nuk e kursente kurrë veten kur e ndjente se me punë mund të arrihej një rezultat real dhe përbuzte rrugët më të shkurtëra, por iluzore që çonin në përfundime formalisht të njëjta, por praktikisht pa ndonjë vlerë. Më kujtohet një mbledhje e Këshillit Shkencor të FShN-së aty nga fillimi i vitit 1958. Ishte hapur drita jeshile për studime pasuniversitare në sistemin e aspiranturës. Pedagogëve me tituj (docent etj.) u lejohej të mos u nënështroheshin provimeve të parashikuara dhe të merreshin drejtpërdrejt me përgatitjen e disertacionit. Ky 'privilegj' i takonte edhe Petraq Pilikës. Por ai në diskutimin e tij të zjarrtë në Këshill e quajti atë një 'vetëgënjim dritëshkurtër' dhe ngulmoi që Këshilli të shprehej në parim kundër kësaj praktike. Dhe ashtu ndodhi.

* * *

Prof. Pepi ishte vërtet njeriu më i përgatitur në fillim të viteve 1950 për t'u bërë misionari i progresit matematik në Shqipëri. Përgatitja është kusht i domosdoshëm, por jo edhe i mjaftueshëm. Në qoftë se ai e përballoi denjësisht këtë detyrë, kjo ndodhi se kishte sensin e qartë e largpamës të vizionit historik. Në 1951, kur hidheshin themelet e arsimit të plotë të lartë matematik, ai u emërua përgjegjës i katedrës së parë të matematikës e të fizikës. Instituti Pedagogjik 2-vjeçar, i krijuar më 1946, kishte qenë një hap i rëndësishëm pozitiv dhe përvoja e tij ishte një mbështetje që s'duhej shpërfillur. Në të punuan me përkushtim figura të nderuara të arsimit tonë si Prof. S. Kuneshka, Prof. Q. Turdiu etj. Megjithatë shkollimi katërvjeçar kërkonte të tjerë parametra. Prof. Pilika nguli këmbë në ndërtimin e një arsimit të lartë matematik të një niveli bashkëkohor, me plane dhe programe mësimore, të paktën në disiplinat themelore, pak a shumë të krahasueshme me ato të vendeve me tradita. Përpilimi i tyre duhej kryer me synimin që strukturat e krijuara të mos lypnin përmbysje kohë më kohë, por të lejonin plotësime dhe azhurnime të natyrshme.

Çka përmenda duket si diçka triviale, por kush e njeh historinë reale të vënies në jetë të këtij synimi e di ç'luftë është dashur për të përballuar e mposhtur mendësi të tilla si 'kujt i duhet tërë kjo matematikë?', 'në kohën që vendi ka uri për mësues matematike e ata duhen përgatitur shpejt, ju kërkoni qiçra në hell e rrekeni t'i kaloni nëpër brimën e gjilpërës' etj., etj., bartës të të cilave ishin edhe persona të veshur me pushtet. Prof. Pilika, i bindur që mbronte një çështje të drejtë, me ndikim në ritmet e përparimit të vendit, nuk lëshoi asnjëherë pé dhe përdori tërë zjarrin e pasionit, mprehtësinë e logjikës, por edhe burrërinë e palëkundshme dhe peshën e autoritetit shkencor e moral të fituar, që nuk mund të nëpërkëmbej kurrësi nga askush. Dhe kështu u ec pa lëkundje në rrugën e përvijuar.

Në mes të viteve 1960 u ngrit edhe profili pesëvjeçar i degës së matematikës, që, pa dyshim, shënonte një hap serioz në thellimin e përgatitjes shkencore të specialistëve të rinj. Ky profil shërbeu edhe për kolaudimin në praktikë të shumë risive, të cilat me kohë zunë vend të qendrueshëm në programet, por, në radhë të parë ai ishte farka e formimit në kushtet tona të një elite matematike, nga e cila, duke i parë gjërat në retrospektivë, nuk jemi aspak të zhgënjyer. Mirëpo, për paradoks, sa herë që ndodhte ndonjë traumë ndryshimesh të radhës që preknin arsimin, ky profil do të vihej në shënjestër e do të etiketohej si 'luks i panevojshëm'. Kohorta laramane e kundërshtarëve, ku përfshiheshin edhe të sëmurët kronikë prej teprisë së zellit në vënie në jetë të slloganeve të kohës, u bind se sa të kishte të bënte me 'ustanë', pesëvjeçari ishte kafshatë e pakapërdishme. Madje, për gati tri dekada, në të gjitha travajat që kaloi shkolla, dega e matematikës jo vetëm nuk u çënuar, por përkundrazi e

përforcoi dhe e plotësoi spektrin e disiplinave shkencore që jepeshin në të. Më vjen mirë të përmend mbledhjen e zgjeruar të degës së matematikës së drejtuar me zotësi nga Prof. Pilika në shkurt të 1969-s. Në atë kohë, kur fakultete të tjera kishin lëshuar pe ndaj presionit të ushtruar duke pranuar shkurtimin e afatit të studimeve, kjo mbledhje u shpreh për afatin trevjeçar të studimeve me një 'jo' të njëzëshme, e cila pati jehonë të menjëhershme sidomos në degët e mësuesisë.

Me të njëjtin vizion Pilika përpunoi edhe strategjinë e kërkimit shkencor në matematikë. Nevoja për të lindi kur u krijua Universiteti më 1957. Nuk mund të ekzistojë një katedër universitare pa qenë edhe një qelizë e veprimtarisë shkencore. Për gati dy vjet, nëpërmjet një programi intensiv të hartuar nga P. Pilika dhe L. I. Kaminjini, katedra iu nënshtroi një procesi 'ndërrimi lëkure', domethënë të shndërrimit të saj në një kolektiv të formuar e me interesa shkencorë dhe me gjykim më të mprehur kritik. Prova e parë e zjarrit ka qenë ajo e nëntorit të 1958-ës kur një specialist i huaj, i ndodhur nën breshërinë e pyetjeve të holla gjatë një paraqitjeje jo fort të kujdesshme të punimeve të veta, kërkoi ndërprerjen e seancës, dhe vazhdimin të nesërmen për të patur kohën e duhur për një përgatitje më serioze.

Zgjedhja e dy fushave ku do të përqendroheshin forcat, e pikërisht analiza funksionale e ekuacionet diferenciale, nuk ishte e rastit, por e argumentuar, sepse nëpërmjet tyre arrihej më shpejt një formim më bashkëkohor i kuadrit, pa humbur sysh edhe zbatimet, ku tregohej vlera dhe efektiviteti i metodave matematike. Kur, vite më vonë, forcat ishin shtuar dhe mund të hidheshin më me siguri hapa në drejtime të tjera, Prof. Pilika më 1972 mbështeti fuqimisht idenë e krijimit të grupeve më të profilizuara shkencore që u bënë bërthama të katedrave të ardhshme më 1987.

Por, ndoshta, ilustrimi më domethënës i vizionit progresiv të P. Pilikës është ideja tejet e guximshme e ngritjes së Qendrës së Matematikës Llogaritëse. Në gjysmën e parë të viteve 1960, duke përfituar me zgjuarësi edhe nga një klimë e favorshme e krijuar atëherë për matematikën, Pilika shtroi si nevojë futjen edhe të teknikës llogaritëse elektronike e të ngritjes së një qendre të specializuar në përdorimin e saj. Për shumëkënd dukej një utopi, dhe e tillë do të kishte mbetur, po ta kishte shprehur këtë ide tjetërkush e jo Pilika, i cili dinte t'i çonte deri në fund gjërat për të cilat ishte i bindur. Shpërfillës i pandreqshëm i labirinteve burokratike, arriti ta fuste në rrugë të mbarë idenë dhe më 1966, si kryetar i delegacionit që shkoi në Kinë për këtë qëllim, negocioi me sukses marrëveshjen për lëvrimin e aparaturave, për kualifikimin e punonjësve të Qendrës së ardhshme dhe ngritjen e saj më 1971. Si pëgjegjës i katedrës, nga e cila ajo varej deri sa u përfshi në strukturat e Akademisë, por

edhe gjatë viteve 1970, Pilika dha një ndihmesë të vyer në orientimin e drejtë të veprimtarisë së saj.

Për të vënë në rrugë të mbarë kërkimin shkencor matematik, aftësia drejtuese dhe organizuese, dhe vizioni i qartë dhe largpamës i P. Pilikës kanë pasur rol vendimtar. Ai dinte të përcaktonte saktësisht objektiva realë, por dhe mobilizues; përvijonte dhe shtigjet më të sigurta për t'i arritur hap pas hapi, natyrisht, me përpjekje jo të zakonshme. Por në këtë fushë ai e kuptonte fare mirë se çfarë force e peshe merrte shembulli personal. Dhe ai diji të bëhet shëmbulltyrë e model për kolegët.

Talenti i P. Pilikës për kërkime origjinale u shfaq që në perudhën e studimeve universitare. Ai kishte rënë në sy të Prof. Menshovit, që e mbajti afër dhe e inkurajoi. Me punimin e vet të diplomës, të paraqitur paraprakisht në disa seanca të seminarit që drejtonte Menshovi, dhe pastaj të mbrojtur shkëlqyeshëm para Komisionit, Pilika tregoi se kishte 'stofin' e një kërkuesi të vërtetë, me të dhëna premtuese.

Në vitin 1957 ai u regjistrua në sistemin e aspiranturës së Fakultetit të Mekanikës dhe të Matematikës, të Universitetit 'Lomonosov' të Moskës, të cilën do ta kryente pa shkëputje nga puna. Praktikisht aspiranturën e filloi në vitin 1958. Si fushë studimesh zgjodhi Teorinë e Funksioneve, ku nën udhëheqjen e Prof. Nikolskit u përcaktua një problematikë që asokohe konsiderohej e mprehtë dhe kërkonte sajimin e mjeteve shumë të holla analitike për ta trajtuar. Po të shprehemi në mënyrë figurative, duheshin përcaktuar si me 'bisturinë e kirurgut' klasat funksionale kufitare në hapësirat $H_{(p)}^{(r)}$. Rezultatet nuk munguan. Ato u paraqitën në disa punime të botuara në revistën 'Doklladi Akademii Nauk SSSR', në vitet 1959, 1960, por edhe në Buletinin e Shkencave Natyrore të FShN-së. Pilika ishte i pari shqiptar, të cilit i hapi faqet e veta një revistë matematike ndër më të mirat në botë. Këtë epitet – *i pari* – do ta përdorim më tej disa herë. Në qershor të 1961-së ai mbrojt disertacionin në Universitetin e Moskës, dhe ishte i pari shqiptar që merrte gradën Kandidat i Shkencave Matematike. Oponencat patën vlerësimet më pozitive. Punimi inkuadrohej mjaft mirë me kërkimin bashkëkohor shkencor. Për vlerat e tij dëshmon fakti se në Konferencën Ndërkombëtare Matematike, mbajtur në Holandë më 1967, në referatin e paraqitur në seancën plenare, rezultatet e Pilikës renditeshin ndër arritjet e spikatura në fushën e posaçme të Teorisë së Funksioneve në dhjetëvjeçarin 1956-1966. Ishte hera e parë që punime të një matematikani shqiptar ziheshin në gojë në një aktivitet shkencor ndërkombëtar të rëndësishëm. Prof. Pilika ato i ka parashtruar edhe në disa universitet të huaja (Shkup, Algjer etj.). Në vitet 1960 i thelloi më tej. Ai diji të amalgamonte mirë punën kërkimore të tij me veprimtarinë pedagogjike.

Fryt i këtij harmonizimi ishin kurset speciale që ndërtoi dhe zhvilloi në auditor, ndër të cilat do të përmendja posaçërisht Teorinë Konstruktive të Funksioneve. Në vitin 1970 për arritjet e tij iu akordua të parit në fushën e matematikës titulli Profesor.

Si shkencëtari ynë më i formuar në matematikë, me krijimin e Akademisë së Shkencave, emri i P. Pilikës u përfshi në listën e anëtarëve të saj, si anëtar korrespondent. Më pas u bë një nga anëtarët titullarë më aktivë të saj dhe figurë qendrore e Seksionit të Shkencave Natyrore-Teknike të Akademisë. Si njeri me përvojë të madhe shkencore dhe organizative, me diskutimet dhe gjykimet e tij të pjekura ka ndikuar në përcaktimin e strategjisë kërkimore në shkallë kombëtare. Nuk kursehej për të dhënë ndihmë edhe konkrete në veprimtaritë shkencore. Ai ishte kryetar i Komisionit Organizues të dy Konferencave Kombëtare të Matematikës (e dyta edhe e Informatikës), të zhvilluara në vitet 1984 dhe 1989, të cilat u konsideruan si një sukses jo i vogël.

Si shkencëtar Pilika ka përfaqësuar Shqipërinë me shumë dinjitet jashtë vendit. Si përfaqësues i Shqipërisë në forumin shkencor të Institutit Ndërkombëtar të Dubnos (1957-1960), si kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Bukureshtit për riformimin e Unionit Ballkanik të Matematikës (1965), si kryetar i delegacionit negociues me Akademinë Kineze të Shkencave (1966), si kryetar i ekipeve tona pjesëmarrëse në Kongreset Botërore të Matematikës (Nicë, 1970 dhe Helsinki, 1978), ose si pjesëmarrës i delegacioneve të tjera; Prof. Pilika ka lënë mbresa të pashlyeshme te kolegët e huaj për aftësitë profesionale, kulturën e gjerë, për sharmin intelektual si bashkëbisedues. Do të përmendja një fakt të vogël, por kuptimplotë. Kur mbrojtja disertacionin, në qershor të 1961-së, marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike kishin hyrë në zonën e acartë të ftohtësisë, ndonëse ende s'ishte bërë asgjë publike. Atmosfera e kërkonte që mbrojtja të bëhej *'in surdine'*. Por kjo nuk ndodhi. Shumë pjesëtarë të elitës matematike të universitetit, por edhe të tjerë që e njihnin Pilikën, nuk mund të mungonin, dhe nuk munguan në mbrojtje sepse e çmonin atë lart, në radhë të parë si njeri me karakter, me personalitet, me kulturë, që dinte t'i bënte vend vetes në çdo mjedis, sado i ngritur të ishte ai.

Natyrisht, veprimtaria e njerëzve të përmasave të Prof. Pilikës, është tepër efikase. Por në qoftë se ajo u kthye në faktor të fuqishëm përparimi për gati gjysmëshekull, kjo ndodhi sepse ai ka pasur një aftësi të rrallë për të nxitur, për t'u dhënë kurajo e guxim, për t'i edukuar me cilësi e virtyte njerëzit me të

cilët ka punuar. Pilika, me modestinë e vet, thekson e përsërit në çdo rast se ka pasur fat të madh në jetë, që është rrethuar nga njerëz të zotë, me të cilët ka qenë i lumtur që ka bashkëpunuar. E thotë këtë me zemër, por me tërë çiltërsinë e shpirtit të tyre edhe ata që kanë punuar nën drejtimin e tij e shprehin se kanë qenë njëqind herë më me fat. Të zotët me të cilët u rrethua i zgjodhi ai, madje duke mos përfillur kriteret jashtëshkencore të kohës, i ndihmoi ai të aftësoheshin më tej e të formonin personalitetin e vet, u hapi horizonte për ta treguar talentin. A nuk ishte Pepi ai që nxiti Aristokli Çiflikun të përballonte me sukses përvetësimin e disiplinës së vështirë të Ekuacioneve të Fizikës Matematike, e paraqitjen e saj dinjitoze në auditoret tona? A nuk e ndjeu Agim Karçanaj në çdo hap mbështetjen e tij për të sendërtuar Matematikën Elementare II apo për të organizuar Olimpiadat Kombëtare të Matematikës? A nuk ishin frymëzimi i 'ustait' dhe detyrimi moral për të mos ia bërë fjalën dy atij, shtysa që Mishel Fundoja të nxirrte duarsh *'Përmbledhjen e ushtrimeve e të problemeve të TFVR-së'*, që do të mbetet një koleksion miniaturash të mirëfillta shkencore origjinale? Cili shprehu një ide racionale e nuk gjeti përkrahjen e Prof. Pepit? A nuk u dëshmuua kjo kur u fut Analiza Funksionale, kur u plotësuan ushtrimotekat e mjaft disiplinave, kur u eksperimentua *'kapitulli zero'* etj., etj.? Tipari më karakteristik që u kultivua në kolektivin e matematikës ishte mungesa e cimirës profesionale, gëzimi për suksesin e tjetrit më shumë se për suksesin e vet. Dhe këto veti ustai ynë i kishte të natyrshme e krejt organike.

Ndodhte që Pilika, kur nuk i pëlqente ndonjë veprim, shprehej me fjalë të forta, por askush nuk i zemërohej. Të gjithë e dinin se ai kërkonte përsosuri e cilësi dhe përpiqeshin t'i arrinin. E përbuzte ngritjen në kult të disiplinës formale, sepse, në thelb, kishte besim te njerëzit, në prirjen e tyre për më të mirën. Ndaj të gjithë bënin çmos të mos e zhgënjenin në këtë besim. Në punë të jepte një ndjenjë sigurie, sepse e dije se të delte në krah, meqë për të nuk peshonte një lajthitje që e frynin meskinët a parimshitesit, por përkushtimi e ndershmëria.

Ndaj studentëve Prof. Pilika ka qenë shumë kërkues. Por, ndër ata që kanë kaluar nëpër duart e tij, nuk gjen as edhe një për bé që ta ketë përfolur rreptësinë e tij si një mani. Ata e kanë ndjerë si diçka të ngjashme me rreptësinë e prindit të përgjegjshëm që ka dhemshuri të vërtetë për fatin e fëmijëve. Prandaj e kanë respektuar dhe të gjithë përmendin me krenari se kanë qenë studentë të tij, duke kujtuar me nostalgji sesi ligjëronte ai në auditor. Më duket se fjala *'ligjërim'* e shqipes është e goditur për të shenjuar mënyrën e tij të komunikimit të dijeve shkencore tek studentët. Stili jo rrallë e

pasqyron besnikërisht njeriun. Pasionant, i zjarrtë, tejet i zhdërvjellët, Prof. Pilika e bënte për vete auditorin. Entuziazmi i tij për një ide të hollë e të bukur të rrëmbente. Ai nuk ishte asnjëherë linear, monoton. Fjala e tij kishte nerv, ritëm. Por, kur përhumbej në përsiatje vetiake, dilte në pah kultura universale e gjykimi i thellë. Ky është ‘arti i mësimdhënies’, siç e quan G. Polya, një nga didaktët më të mëdhenj. Njeriu mëson nga librat e shkruar me mençuri, por mëson, madje më tepër ‘nga mjeshtërit e vërtetë të fjalës në auditor’, e një mjeshtër i tillë është dhe do të mbetet Profesori ynë i dashur. Këtë gjykim të njëzëshëm e konsakroi edhe titulli Mësues i Popullit, që iu akordua atij më 1983. Në një rrafsh më të përgjithshëm për veprimtarinë e tij të frytshme shkencore e pedagogjike, dhe rolin e madh që ka luajtur ai në përparimin e vendit, ne sektorin të cilit iu përkushtua me mish dhe më shpirt, Presidenti i Republikës më 2004 i akordoi dekoratën e lartë Mjeshtër i Madh i Punës.

* * *

Më pëlqen ta mbyll me një episod. Në maj të 1982-shit sa kishim mbërritur në Sarandë me Prof. Pepin, nje etapë kjo e turneut të përvitshëm për zgjedhjen e studentëve për degën e matematikës. Po pushonim në tarracën e barit të hotelit, kur na u afrua e na përshëndeti një ish-studenti ynë, por nuk u ul me ne. Nuk kishte kaluar as gjysmë ore, kur si me magji u mblodhën rreth profesorit thujse të gjithë ish-studentët e matematikës që ndodheshin në qytet, natyrisht bashkë me të parin që na takoi. I solli aty një ndjenjë përgjërimi, malli e dashurie. Ndenjën vonë atë natë, të etur për të dëgjuar sërish fjalën e mençur të profesorit. Ishte një mbrëmje e paharruar! Kujtova një episod, por unë jam dëshmitar i dhjetëra manifestimeve të tilla të ndjenjave shumë të fuqishme e të pastra të dashurisë dhe të respektit për ‘ustanë’ tonë të shtrenjtë – Prof. Petraq Pilikën.